VENDIM
Nr. 107, datë 30.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE NR. 99, DATË 16.10.2020, "AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE 'MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA 'TË GJELBRA', TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKOMIQËSOR OSE BIZNESE EKZISTUESE, TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË BIZNESE 'TË GJELBRA', DUKE FUTUR ELEMENTE *GOGREEN* NË TO'"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:
- znj. Delina Ibrahimaj – kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi – anëtare;
- znj. Inida Methoxha – anëtare;
- znj. Brikena Qela – anëtare;
- z. Ahmet Mançellari – anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 30.9.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 23750, datë 27.6.2022 "Kërkesë për shtyrjen e afatit të Autorizimit të Ndihmës Shtetërore për vitin 2023".

Bashkia e Tiranës referon se në pikën 2, të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 167, datë 18.12.2020, "Për miratimin e projektit 'Mbështetje Financiare (grant) për biznese të reja të gjelbra, të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbra', duke futur elemente *gogreen* në to'", është përcaktuar, se: "*efektet financiare të këtij projekti do të përballohen nga fondi për programin 'Mbështetje për zhvillimin ekonomik' të parashikuar në buxhetin e bashkisë Tiranë për vitin 2021–2023*".

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4, të kreut II "Përshkrimi i masës", të vendimit të KNSH-së nr. 99, datë datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbra', të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbra', duke futur elemente *gogreen* në to", në:

"Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2020–2023."

2. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj